



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr.1, Datë 07.11.2014

PËR

**IDENTIFIKIMIN E BREZIT TË URBANIZUAR PËRGJATË KORRIDORIT
TIRANË-DURRËS DHE MIRATIMIN E HARTËS KU MUND TË NDËRHYHET NË
FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Në mbështetje të neneve 5, 7, 9, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe të VKM-së Nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Identifikimin e brezit të urbanizuar përgjatë korridorit Tiranë – Durrës, sipas hartës bashkëlidhur;
2. Brezi i urbanizuar referuar këtij Vendimi është 200 m nga secili krah i trupit të rrugës përfshirë dhe brezin e rezervuar referuar Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor.
3. Miratimin e zhvillimeve urbane në brezin e urbanizuar, përcaktuar si më sipër, për të gjitha kategoritë e bonitetit të tokës bujqësore, me kusht që:
 - a) të respektohen instrumentet e planifikimit ekzistuese dhe/ose në proces;
 - b) propozimi për ndërtim të miratohet vetëm pas konfirmimit nga AKPT të përputhshmërisë së tij me instrumentet e planifikimit ekzistuese dhe/ose në proces;
 - c) t’i jepet prioritet, në çdo rast, mbushjes urbane të zonave të ndërtuara, duke shfrytëzuar infrastrukturën ekzistuese;
 - d) në rastet kur më shumë se 80 % e sipërfaqes së parcelës shtrihet brenda brezit të urbanizuar, e gjithë sipërfaqja e parcelës konsiderohet sipërfaqe e urbanizueshme.
4. Ngarkohet AKPT-ja të veprojë si zyrë shërbimi me një ndalesë për kontrollin e përputhshmërisë të kërkesave për leje ndërtimi me qëllim lehtësimin e procesit të bashkërendimit me të gjitha autoritetet qendrore dhe vendore për realizimin e investimit.

5. Konvertimi nga tokë "arë" në tokë "trual" për sipërfaqet brenda këtyre zonave do të bëhet sipas procedurave ligjore përkatëse.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. EDMOND PANARITI

MINISTËR I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

